



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Këshilli i Ministrave

*Z. Ardi  
Dilipovski*

V E N D I M

Nr. 641 , datë 18.9.2003

P Ë R

SHËNJA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.665,  
DATË 18.12.2002, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,  
"PËR MIRATIMIN E KONTRATËS, NDËRMJET OEVERISË SË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE LOCKHEED MARTIN  
GLOBAL INC. PËR MODERNIZIMIN E SHËRBIMIT TË  
TRAFIKUT AJROR SHQIPTAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.7877, datë 30.11.1994, "Për Aviacionin Civil Shqiptar", të ligjit nr.7928, datë 28.5.1995, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", dhe të pikës 3, të nenit 17, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin nr.665, datë 18.12.2002, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Vlefata e TVSh-së dhe taksat doganore nuk janë të përfshira në vlerën e kontratës. TVSh-ja dhe taksat doganore të paguhen nga blerësi, pas dorëzimit të faturës për shërbime të diferencuara."

2. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1 Lejimin e Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror, sha, që, për fondin prej 29 682 807 (njëzetdhjetë milionë e gjashtëqindetëdhjetë mijë e tetëqindeshtatë) USD-sh, të vazhdojë përdorimin e procedurës “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me shoqërinë ndërkombëtare Lockheed Martin Global Inc, për zbatimin e fazës së dytë, në përputhje me projektkontratën e miratuar në pikën 1, të vendimit.”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Vlefshmëria e kontratës për zbatimin e fazës së dytë të projektit është e lidhur dhe do të zbatohet, në përputhje me burimet financiare që zotëron ANTA, sha, të cilat janë të pasqyruara në planbiznesin e shoqërisë, deri në çastin e hyrjes në fuqi të marrëveshjes financiare të kredisë për këtë qëllim.”.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

FATOS NANG

MINISTRI I TRANSPORTIT  
DHE I TELEKOMUNIKACIONIT

SPARTAK POÇI



NR.PROT.2789/1  
DATË 26.9.2003

PRESIDENCËS  
MINISTRISË SË TRANSPORTIT  
DHE TË TELEKOMUNIKACIONIT  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
MINISTRISË SË FINANCAVE  
MINISTRISË SË EKONOMISË  
AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK  
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

  
YLLI MANJANI

**Republic of Albania**  
**Council of Ministers**

**DECISION**

**No 641, date 18.09.2003**

**FOR SOME ADDITIONS AND AMENDMENTS IN THE  
DECISION NO: 665, DATE 18.12.2002 OF THE COUNCIL  
OF THE MINISTERS "FOR THE APPROVAL OF THE  
PROJECT-CONTRACT, BETWEEN THE GOVERNMENT OF  
THE REPUBLIC OF ALBANIA AND LOCKHEED MARTIN  
GLOBAL INC. FOR THE MODERNIZATION OF THE  
ALBANIAN AIR-TRAFFIC SERVICE.**

Based on article 100 of the Constitution, of article 7 law no. 7877, date 30.11.1994 "For Albanian civil aviation", law nr. 7928, date 28.05.1995 " For Value Added Tax" and section 3 of article 17 of law no. 7971, date 26.07.1995" For public procurement", amended, with the proposal of the Ministry of Transports and Telecommunication, Council of Ministers

**DECIDED**

In the decision no. 665, date 18.12.2002 of the Council of Ministers should be made these amendments:

1. In section 1 should be added the paragraph as follows:  
"The amount of VAT and custom duties is not included in the amount of the contract. VAT and custom duties should be paid by the purchaser, after the entrance of the invoice for differentiated services."

After section 2, should be added section 2/1 as follows:"2/1 the authorization NATIONAL AIR TRAFFIC AGENCY (NATA), with its fund of 29 682 807 (twenty nine million and six hundred and eighty two thousand and eight hundred and seven) USD, to use the procedure "Direct Procurement" with the international company" Lockheed Martin Global, for the

execution of the second clause, in accordance with the project-contract approved with the first clause of the Decision:"

3. The third clause changes as follows:

"3. The validity of the contract of the execution of the second clause of the project is connected and will be executed, in accordance with the financial sources that ANTA S. a., owns, which are presented in the Business plan of the company, until the moment when the financial credit agreement will be legal and used for this purpose."

This decision enters into force immediately and is published in the "Official Bulletin"

**PRIME MINISTER**

**FATOS NANO**

MINISTER OF TRANSPORT  
AND TELECOMMUNICATION

SPARTAK POCI